

**VENDIM**

Nr. 775, datë 4.12.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT
KONTRAKTUES PËR NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË KONTRATËS
KONCESIONARE NR. 8618, DATË
14.8.2014, “PËR BURIMIN UJOR ‘SASAJ,
BUNEC’”, TË LIDHUR NDËRMJET
ISH-MINISTRISË SË MJEDISIT DHE
SHOQËRISË “BLUE EYE ONE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si të vetmin autoritet kontraktues për ndjekjen e zbatimit të kontratës koncesionare nr. 8618, datë 14.8.2014, “Për burimin ujor ‘Sasaj, Bunec’”, të lidhur ndërmjet ish-Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “Blue Eye One”.

2. Ndjekja e zbatimit të kontratës koncesionare do të bëhet nëpërmjet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila do të raportojë në vazhdimësi tek autoriteti kontraktues dhe do t’i propozojë atij kryerjen e veprimeve procedurale, që do të duhet të ndërmerren gjatë zbatimit të kontratës, si dhe marrjen e masave në rast shkeljeje.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**